Depozitimet e yndyrës në filtrat e yndyrës mund të marrin flakë.

- ▶ Mos e përdorni asnjëherë pajisjen pa filtrin e yndyrës.
- ▶ Pastroni rregullisht filtrin e yndyrës.
- ▶ Asnjëherë mos punoni në afërsi të pajisjes me një flakë të zbuluar (p.sh. me ushqime me flakë).
- ▶ Pajisjen mund ta instaloni në afërsi të një prodhuesi nxehtësie me lëndë djegëse të ngurta (p.sh. dru ose qymyr), vetëm kur ka ai një kapak të mbyllur dhe që nuk hiqet. Jashtë tij nuk duhet të dalin shkëndija.

Vaji dhe yndyra e nxehtë marrin flakë shpejt.

- ▶ Mbikëqyrni vazhdimisht vajin dhe yndyrën e nxehtë.
- ▶ Kurrë mos e fikni me ujë një zjarr nga vaji ose yndyra e nxehtë. Fikni vatrën e gatimit. Mbuloni flakët me kujdes me një mbulesë, me mbulesë për fikjen e zjarrit ose materiale të ngjashme.

Vatrat e gatimit me gaz që nuk kanë enë gatimi sipër lëshojnë shumë nxehtësi gjatë kohës që janë në punë. Pajisja e ajrimit e montuar sipër tyre mund të dëmtohet ose të marrë flakë.

- ▶ Ndizini vatrat e gatimit me gaz vetëm kur sipër tyre janë vendosur enë gatimi.
- Kur përdorni njëkohësisht disa vatra gatimi me gaz, krijohet nxehtësi e madhe. Pajisja e ajrimit e montuar sipër tyre mund të dëmtohet ose të marrë flakë.
- ▶ Ndizini vatrat e gatimit me gaz vetëm kur sipër tyre janë vendosur enë gatimi.
- ▶ Vendosni nivelin maksimal të shpejtësisë së ventilatorit.
- ▶ Mos përdorni asnjëherë njëkohësisht dy vatra gatimi me gaz me flakë të madhe për më shumë se 15 minuta. Dy vatra gatimi me gaz korrespondojnë me një vatrë të madhe.
- ▶ Asnjëherë mos e përdorni vatrën e madhe me flakë të madhe me mbi 5 kW, për më shumë se 15 minuta, p.sh. me Wok.

**⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik djegiesh!**

Pjesët e arritshme nxehen shumë gjatë përdorimit.

- ▶ Mos i prekni asnjëherë pjesët e nxehta.
- ▶ Mbani fëmijët larg.

Pajisja nxehet kur punon.

- ▶ Përpara pastrimit, lëreni pajisjen të ftohet.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!**

Pjesët brenda pajisjes mund të jenë me qoshe të mprehta.

- ▶ Pastroni me kujdes hapësirën e brendshme të pajisjes.

Ndryshimet në sistemin elektrik apo mekanik janë të rrezikshme dhe mund të çojnë në keqfunksionim.

- ▶ Mos bëni asnjë ndryshim në sistemin elektrik ose mekanik.

Kapaku i filtrit mund të lëkundet.

- ▶ Hapeni me ngadalë kapakun e filtrit.
- ▶ Pas hapjes mbani të kapur kapakun e filtrit derisa ai të mos lëkundet më.
- ▶ Mbyllni me ngadalë kapakun e filtrit.

Drita e llambave LED është shumë e ndritshme dhe mund të dëmtojë sytë (grupi i rrezikut 1).

- ▶ Mos e shihni drejtpërdrejt llambën e ndezur LED për më shumë se 100 sekonda.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!**

Lagështia që futet brenda mund të shkaktojë goditje elektrike.

- ▶ Para pastrimit, hiqni spinën nga priza ose fikni siguresën në kutinë e siguresave.
- ▶ Mos përdorni pastrues me avull ose pastrues me presion të lartë për të pastruar pajisjen.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik shpërthimi!**

Produktet e forta gërryese të pastrimit ose me përmbajtje të lartë acide mund të shkaktojnë shpërthime në kombinim me pjesët e aluminit në hapësirën e larjes së enëlarëses.

- ▶ Mos përdorni asnjëherë produkte pastrimi të forta gërryese ose me përmbajtje të lartë acide. Në veçanti, mos përdorni asnjë produkt pastrimi profesional ose industrial lidhur me pjesët e aluminit, si p.sh. filtri i yndyrës i aspiratorëve të kuzhinës.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik zjarri!**

Depozitimet e yndyrës në filtrat e yndyrës mund të marrin flakë.

- ▶ Pastroni rregullisht filtrin e yndyrës.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!**

Riparimet e papërshtatshme janë të rrezikshme.

- ▶ Vetëm personeli i trajnuar duhet të kryejë riparime në pajisje.
- ▶ Nëse pajisja ka defekt, atëherë telefononi shërbimin e klientit.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!**

Lagështia që futet brenda mund të shkaktojë goditje elektrike.

- ▶ Mos përdorni asnjë pecetë me sfungjer të lagur.

---

## **2 Shmangia e dëmeve materiale**

### **VINI RE!**

Uji i kondensuar mund të çojë në dëme nga korrozioni.

- ▶ Për të shmangur formimin e ujit të kondensuar ndizeni gjithmonë pajisjen gjatë gatimit.

Futja e lagështisë në elementet e komandimit mund të shkaktojë dëme.

- ▶ Asnjëherë mos i pastroni elementet e komandimit me pecetë të njomë.

Pastrimi në mënyrë të gabuar dëmton sipërfaqen.

- ▶ Ndiqni udhëzimet e pastrimit.
- ▶ Mos përdorni mjete pastrimi të mprehta ose gërryese.
- ▶ Pastrojini sipërfaqet prej inoksi vetëm në drejtim të lustrës.
- ▶ Asnjëherë mos i pastroni elementet e komandimit me pastrues për inoks.

Uji i kondensuar që rrjedh mbrapsht mund të dëmtojë pajisjen.

- ▶ Kanali i largimit të ajrit nga pajisja duhet instaluar me pjerrësi të paktën 1°.

Kur forca e ushtruar mbi elementet e dizajnit është e tepruar, ato mund të prishen.

- ▶ Mos u mbështetni mbi elementet e dizajnit.
- ▶ Mos vendosni objekte mbi elementet e dizajnit ose mos varni objekte tek ato.

Dëmtim i sipërfaqes nga mos-heqja e qeses mbrojtëse.

- ▶ Hiqni qesen mbrojtëse nga të gjitha pjesët e pajisjes përpara përdorimit për herë të parë.

Sipërfaqet e lyera janë delikate.

- ▶ Ndiqni udhëzimet e pastrimit.  
→ "Pastrimi i pajisjes", Faqe 21
- ▶ Mbroni sipërfaqet e lyera nga gërvishtjet.

## 3 Mbrojtja e mjedisit dhe kursimi

### 3.1 Hedhja e paketimit

Materialet e paketimit janë ekologjike dhe të riciklueshme.

- ▶ Hidhni pjesët e caktuara të seleksionuara sipas llojit.

### 3.2 Kursimi i energjisë

Nëse i ndiqni këto udhëzime, pajisja juaj harxhon më pak energji elektrike.

Përshtatni nivelin e ventilatorit me intensitetin e avujve të gatimit.

- Një nivel më i ulët i ventilatorit të aspiratorit, do të thotë konsum më i ulët i energjisë.
- Përdorni nivelin intensiv vetëm në rast nevojë.

Në rastin e avujve intensivë të gatimit zgjidhni paraprakisht një nivel të lartë të ventilatorit të aspiratorit.

- Aromat përhapen më pak në dhomë.

Fikni ndriçimin kur të mos ju nevojitet më.

- Kur ndriçimi është i fikur, ai nuk harxhon fare energji.

Pastroni ose ndërroni filtrin sipas intervaleve të dhëna.

- Efektiviteti i filtrit do të ruhet.

Vendosni kapakun e tenxheres.

- Avujt e gatimit dhe uji i kondensuar do të zvogëlohen.

Përdorni funksionet shtesë vetëm në rast nevojë.

- Fikja e funksioneve shtesë zvogëlon konsumin e energjisë.

## 4 Vendosja e treguesit të ngopjes

Ju mund ta përdorni pajisjen në modalitetin me qarkullim ajri ose në modalitetin me nxjerrje ajri.

### 4.1 Modaliteti me nxjerrje ajri

Ajri i thithur pastrohet përmes filtrit të yndyrës dhe nxirret jashtë përmes një sistemi tubash.



Ajri nuk duhet të shkarkohet në një oxhak që përdoret për shkarkimin e gazrave të pajisjeve që djegin gaz apo lëndë djegëse të tjera (kjo nuk vlen për pajisjet që qarkullojnë ajrin).

- Nëse shkarkimi i ajrit do të bëhet në një oxhak tymi ose gazi që nuk është në përdorim, duhet marrë paraprakisht aprovimi i kompanisë përkatese përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemit të oxhakëve.
- Nëse nxjerrja e ajrit do të bëhet përmes murit të jashtëm, duhet të përdoret një tub teleskop me grilë.

### 4.2 Modaliteti me qarkullim ajri

Ajri i thithur pastrohet përmes filtrit të yndyrës dhe një filtri për aromat dhe pastaj futet sërish në dhomë.




Për të thithur aromat e kuzhinës në modalitetin me qarkullim ajri, duhet të instaloni një filtër për aromat. Mundësitë e ndryshme për ta përdorur pajisjen në modalitetin me qarkullim ajri mund t'i gjeni në katalogun tonë ose mund të pyesni shitësin e specializuar. Aksesoret e nevojshëm i gjeni në dyqanin e specializuar ose te shërbimi i klientit ose në dyqanin online.  
→ "Aksesoret", Faqe 20

## 5 Njohja

### 5.1 Elementet e komandimit

Përmes elementeve të komandimit ju aktivizoni të gjitha funksionet e pajisjes dhe merrni informacion për gjendjen e funksionimit.



①	Fikja e pajisjes ose ndezja e nivelit 1 të ventilatorit
2	Ndizni nivelin 2 të ventilatorit.
3/∧	Ndizni nivelin 3 të ventilatorit ose nivelin intensiv.
∧	Ndizni ose fikni ndriçimin.

## 6 Aksesorët

Aksesorët mund t'i blini pranë shërbimit të klientit, në dyqanet e specializuara ose në internet. Përdorni vetëm aksesorë origjinalë, sepse ato janë të përshtatur saktësisht për pajisjen tuaj.

Aksesorët janë specifikë sipas pajisjes. Kur blini aksesorë duhet të jepni gjithmonë emërtimin e saktë (E-Nr.) të pajisjes suaj. → *Faqe 24*

Aksesorët që disponohen posaçërisht për pajisjen tuaj mund t'i mësoni në katalogun tonë, në dyqanin online ose te shërbimi për klientin.

www.bosch-home.com

Aksesorët	Numri i porosisë
Filtri standard i aromave	DHZ5316
Seti standard i qarkullimit të ajrit	DHZ5605
Seti i qarkullimit të ajrit Clean Air Plus	DWZ1IX1C6
Filtri i aromave Clean Air Plus (rezervë)	DWZ1IX1B6
Seti i qarkullimit të ajrit Long Life	DWZ1IT1D1
Filtri i aromave Long Life (rezervë)	DWZ0IT0P0

## 7 Përdorimi bazë

### 7.1 Ndezja e pajisjes

- ▶ Shtypni ①.
- ✓ Pajisja nis punën në nivelin 1 të ventilatorit.

### 7.2 Vendosja e nivelit të ventilatorit

- ▶ Shtypni ①, 2 ose 3/4.

#### Shënim

Niveli i vendosur i ventilatori tregohet nëpërmjet treguesit LED:

- Niveli 1 i ventilatorit: LED ndriçon në ngjyrë jeshile.
- Niveli 2 i ventilatorit: LED ndriçon në ngjyrë portokalli.
- Niveli 3 i ventilatorit: LED ndriçon në ngjyrë të kuqe.

### 7.3 Fikja e pajisjes

- ▶ Shtypni ①.

**Shënim** Nëse është ndezur niveli 2 ose 3 i ventilatorit, shtypni ① dy herë.

### 7.4 Ndezja e nivelit intensiv

Ju mund të përdorni nivelin intensiv veçanërisht kur krijohen aroma të forta ose kur krijohet shumë avull.

- ▶ Mbani shtypur 3/4.
- ✓ Treguesi LED pulson në ngjyrë të kuqe.
- ✓ Pas rreth 6 minutash pajisja kalon automatikisht në një nivel më të ulët të ventilatorit.

**Shënim** Ju mund ta ndizni nivelin intensiv direkt nga gjendja fikur. Pas kalimit të kohës prej 6 minutash, pajisja fiket përsëri.

### 7.5 Ndezja e ndriçimit

Dritën mund ta ndizni dhe ta fikni në mënyrë të pavarur nga aspirimi.

- ▶ Shtypni ②.

### 7.6 Fikja e ndriçimit

- ▶ Shtypni ②.

## 8 Pastrimi dhe kujdesi

Në mënyrë që pajisja të qëndrojë funksionale për kohë të gjatë, pastrojeni dhe kujdesuni për të me kujdes.

### 8.1 Produktet e pastrimit

Produktet e përshtatshme të pastrimit mund t'i blini te shërbimi i klientit ose në dyqanin online.

#### VINI RE!

Produktet e papërshtatshme të pastrimit mund të dëmtojnë sipërfaqen e pajisjes.

- ▶ Mos përdorni mjete pastrimi të mprehta ose gërryese.
- ▶ Mos përdorni produkte pastrimi që përmbajnë shumë alkool.
- ▶ Mos përdorni tela të forta ose sfungjerë të ashpër.
- ▶ Mos përdorni asnjë pastrues special për pastrim në të ngrohtë.

- ▶ Përdorni pastrues për xhama, shpatull për xhama ose produkte kujdesi për inoks vetëm kur këto rekomandohen për pjesën përkatëse në manualin e pastrimit.
- ▶ Lani mirë pecetat me sfungjer përpara se t'i përdorni.

## 8.2 Pastrimi i pajisjes

Pastroni pajisjen ashtu siç rekomandohet, në mënyrë që pjesët dhe sipërfaqet e ndryshme të mos dëmtohen si pasojë e mënyrës së gabuar të pastrimit apo si pasojë e përdorimit të produkteve të papërshtatshme të pastrimit.

### ⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik shpërthimi!

Produktet e forta gërryese të pastrimit ose me përmbajtje të lartë acide mund të shkaktojnë shpërthime në kombinim me pjesët e aluminit në hapësirën e larjes së enëlarëses.

- ▶ Mos përdorni asnjëherë produkte pastrimi të forta gërryese ose me përmbajtje të lartë acide. Në veçanti, mos përdorni asnjë produkt pastrimi profesional ose industrial lidhur me pjesët e aluminit, si p.sh. filtri i yndyrës i aspiratorëve të kuzhinës.

### ⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!

Lagështia që futet brenda mund të shkaktojë goditje elektrike.

- ▶ Para pastrimit, hiqni spinën nga priza ose fikni siguresën në kutinë e siguresave.
- ▶ Mos përdorni pastrues me avull ose pastrues me presion të lartë për të pastruar pajisjen.

### ⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik djegiesh!

Pajisja nxehet kur punon.

- ▶ Përpara pastrimit, lëreni pajisjen të ftohet.

### ⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!

Pjesët brenda pajisjes mund të jenë me qoshe të mprehta.

- ▶ Pastroni me kujdes hapësirën e brendshme të pajisjes.

1. Shikoni informacionet për produktet e pastrimit.

2. Në varësi nga lloji i sipërfaqes, veproni si më poshtë:
- Pastrojini sipërfaqet prej inoksi me një pecetë me sfungjer dhe ujë të ngrohtë me detergjent në drejtimin e lustrës.
  - Pastrojini sipërfaqet e lyera me një pecetë me sfungjer dhe ujë të ngrohtë me detergjent.
  - Pastrojini sipërfaqet prej alumini me një pecetë të butë dhe pastrues për xhama.
  - Pastrojini sipërfaqet plastike me një pecetë të butë dhe pastrues për xhama.
  - Pastrojini sipërfaqet prej xhami me një pecetë të butë dhe pastrues për xhama.

3. Më pas thajini me një pecetë të butë.

4. Në sipërfaqet prej inoksi, përhapni një shtresë të hollë produkti kujdesi për inoks me një pecetë të butë.

Produktin e kujdesit për inoks mund ta blini te shërbimi për klientin ose në dyqanin online.

## 8.3 Pastrimi i elementeve të komandimit

### ⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!

Lagështia që futet brenda mund të shkaktojë goditje elektrike.

- ▶ Mos përdorni asnjë pecetë me sfungjer të lagur.

1. Shikoni informacionet për produktet e pastrimit.

2. Pastrojini sipërfaqet me një pecetë me sfungjer të lagësht dhe ujë të ngrohtë me detergjent.

3. Më pas thajini me një pecetë të butë.


## 8.4 Çmontimi i filtrit të yndyrës

### ⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!

Kapaku i filtrit mund të lëkundet.

- ▶ Hapeni me ngadalë kapakun e filtrit.
- ▶ Pas hapjes mbani të kapur kapakun e filtrit derisa ai të mos lëkundet më.
- ▶ Mbyllni me ngadalë kapakun e filtrit.

1. Ulni për poshtë kapakun e filtrit për ta hapur.




2. VINI RE!

Filtri i yndyrës që rrëzohet poshtë mund të dëmtojë planin e gatimit që ndodhet poshtë tij.

- ▶ Kapni nga poshtë filtrin e yndyrës me një dorë.

Hapni kapëset e mbylljes në filtrat e yndyrës.



3. Nxirrni filtrin e yndyrës nga mbajtësja.

Mbajeni horizontalisht filtrin e yndyrës për të shmangur pikimin e pikave të yndyrës.

## 8.5 Pastrimi i filtrave të yndyrës me dorë

Filtrat e yndyrës filtojnë yndyrën nga avujt e gatimit në kuzhinë. Filtrat e yndyrës që pastrohen rregullisht garantojnë një shkallë të lartë të largimit të yndyrës.

### ⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik zjarri!

Depozitimet e yndyrës në filtrat e yndyrës mund të marrin flakë.

**Kërkesë:** Filtrat e yndyrës janë të çmontuar.

→ "Çmontimi i filtrit të yndyrës", Faqe 21

1. Shikoni informacionet për produktet e pastrimit.

2. Zhytni filtrat e yndyrës në ujë të ngrohtë me detergjent.

Kur ka ndotje të vështira, përdorni një largues yndyre. Larguesin e yndyrës mund ta blini te shërbimi për klientin ose në dyqanin online.

3. Pastroni filtrat e yndyrës me një furçë.

4. Shpëlani mirë filtrat e yndyrës pas pastrimit.

- Lërimi filtrat e yndyrës të pikojnë mirë.

## 8.6 Pastrimi i filtrave të yndyrës në lavastovilje

Filtrat e yndyrës filtojnë yndyrën nga avujt e gatimit në kuzhinë. Filtrat e yndyrës që pastrohen rregullisht garantojnë një shkallë të lartë të largimit të yndyrës.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik zjarri!**

Depozitimet e yndyrës në filtrat e yndyrës mund të marrin flakë.

### **VINI RE!**

Filtrat e yndyrës mund të dëmtohen si rezultat i ngecjes.

- Mos i ngecni filtrat e yndyrës.

**Shënim** Në rast pastrimi të filtrit të yndyrës në lavastovilje, mund të ndodhin çngjyrosje të lehta. Çngjyrosjet nuk kanë asnjë ndikim në funksionimin e filtrit të yndyrës.

**Kërkesë:** Filtrat e yndyrës janë të çmontuar.

→ "Çmontimi i filtrit të yndyrës", Faqe 21

- Shikoni informacionet për produktet e pastrimit.
- Vendoseni filtrin e yndyrës në gjendje të lirë në lavastovilje.  
Nëse filtri i yndyrës është shumë i ndotur, atëherë mos e lani së bashku me enët.  
Kur ka ndotje të vështira, përdorni një largues yndyre. Larguesin e yndyrës mund ta blini te shërbimi për klientin ose në dyqanin online.
- Ndizni lavastoviljen.  
Gjatë vendosjes së temperaturës zgjidhni maksimumi 70°C.
- Lërimi filtrat e yndyrës të pikojnë mirë.

## 8.7 Montimi i filtrit të yndyrës

### **VINI RE!**

Filtri i yndyrës që rrëzohet poshtë mund të dëmtojë planin e gatimit që ndodhet poshtë tij.

- Kapni nga poshtë filtrin e yndyrës me një dorë.

- Vendosni në vend filtrin e yndyrës.
- Ngrini për lart filtrin e yndyrës dhe mbërtheni kapëset e mbylljes.
- Sigurohuni që kapëset e mbylljes janë të kyçura siç duhet.
- Mbyllni kapakun e filtrit.


## 8.8 Filtri i aromave për modalitetin me qarkullim ajri

Filtrat e aromave i mbledhin aromat në modalitetin me qarkullim ajri. Filtrat e aromave që ndërrohen rregullisht garantojnë një shkallë të lartë të largimit të aromave. Filtri i aromave duhet të ndërrohet çdo 4 muaj, kur pajisja përdoret normalisht, rreth një orë çdo ditë. Filtri i aromave nuk mund të pastrohet apo të rigjenerohet. Filtrin e aromave ta blini te shërbimi për klientin ose në dyqanin online. Përdorni vetëm filtër aromash origjinal.


### **Çmontimi i filtrit të aromave**

- Çmontoni filtrin e yndyrës. → Faqe 21


- Hiqni filtrin e aromave nga mbajtësja.



- Rrotulloni filtrin e aromave rreth motorit.




- Nxirrni jashtë filtrin e aromave.




### **Montimi i filtrit të aromave**


- Shtyni filtrin e aromave brenda në aspirator.



2. Rrotulloni filtrin e aromave rreth motorit.



3. Shtyni me kujdes filtrin e aromave brenda në mbajtëse.



4. Montoni filtrin e yndyrës.

## 9 Mënjanimi i defekteve

Defektet e lehta në pajisje mund t'i eliminoni edhe vetë. Përdorni informacionet për eliminimin e defekteve përpara se të kontaktoni me shërbimin për klientin. Kështu shmangni shpenzimet e panevojshme.

### ⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!

Riparimet e papërshtatshme janë të rrezikshme.

- ▶ Vetëm personeli i trajnuar duhet të kryejë riparime në pajisje.
- ▶ Nëse pajisja ka defekt, atëherë telefononi shërbimin e klientit.

### ⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!

Riparimet e gabuara janë shkak për rreziqe.

- ▶ Riparimet në pajisje duhen kryer vetëm nga staf teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- ▶ Për riparimin e pajisjes lejohet të përdoren vetëm pjesë këmbimi origjinale.
- ▶ Nëse dëmtohet kordoni elektrik i pajisjes, atëherë ai duhet të zëvendësohet nga teknik i trajnuar.

### 9.1 Ndërrimi i ndriçuesve LED me defekt

- ▶ Ndriçuesit LED me defekt duhet të ndërrohen vetëm nga prodhuesi, nga shërbimi i tij për klientin ose nga një teknik specialist i autorizuar (elektricit).

### 9.2 Defektet e funksionit

Defekti	Shkaku dhe zgjidhja e problemeve
Pajisja nuk funksionon.	Spina e kabllot së lidhjes elektrike nuk është futur. <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Lidhni pajisjen në rrjetin elektrik.</li> </ul>
	Siguresa ka defekt. <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Kontrolloni siguresën në kutinë e siguresave.</li> </ul>
	Është ndërprerë furnizimi me energji. <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Kontrolloni nëse ndriçimi i dhomës dhe pajisjet e tjera funksionojnë.</li> </ul>
Ndriçimi nuk funksionon.	Llamba LED ka defekt. <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Telefonojini shërbimit të klientit.</li> <li>▶ Ndriçuesit LED me defekt duhet të ndërrohen vetëm nga prodhuesi, nga shërbimi i tij për klientin ose nga një teknik specialist i autorizuar (elektricit).</li> </ul>

## 10 Hedhja

### 10.1 Hedhja e pajisjes së vjetër

Me hedhjen e pajisjeve në mënyrë të përshtatshme për mjedisin mund të rifitohen lëndë të para të vlefshme.

- ▶ Hidhni pajisjen në mënyrë të përshtatshme për mjedisin. Informacioni për mënyrat aktuale të hedhjes mund të merret nga shitësi specialist, si dhe pranë administratës vendore të komunës ose qytetit.



Ky aparat përmban shënjën e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2012/19/EU (waste electrical and electronic equipment - WEEE). Udhëzimi jep kuadrin ligjor për te drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

## 11 Shërbimi i klientit

Pjesët origjinale të këmbimit të rëndësishme për funksionimin, në përputhje me rregulloren përkatëse të dizajnit ekologjik, i gjeni te shërbimi ynë për klientin për një periudhë të paktën 10 vjet pas vënies në qarkullim të pajisjes suaj brenda Zonës Ekonomike Evropiane.

**Shënim** Përdorimi i shërbimit të klientit është falas në kuadrin e kushteve të garancisë së prodhuesit.

Informacionet e detajuara rreth periudhës së garancisë dhe kushteve të garancisë në vendin tuaj i gjeni te shërbimi ynë i klientit, shitësi juaj ose në faqen tonë të internetit.

Nëse kontaktoni shërbimin e klientit, ju nevojitet numri i produktit (E-Nr.) dhe numri i prodhimit (FD) i pajisjes suaj.

Të dhënat e kontaktit të shërbimit për klientin i gjeni në listën bashkëlidhur të pikave të shërbimit për klientin ose në faqen tonë të internetit.

### 11.1 Numri i produktit (E-Nr.) dhe numri i prodhimit (FD)

Numrin e produktit (E-Nr.) dhe numrin e prodhimit (FD) e gjeni në tabelën e modelit të pajisjes.

Në varësi nga modeli, etiketa e parametrave të tipit ndodhet:

- në brendësi të pajisjes (për këtë duhet të çmontoni filtrin e yndyrës).
- në pjesën e sipërme të pajisjes.

Ju mund t'i mbani shënim këto të dhëna, për t'i gjetur shpejt përsëri të dhënat e pajisjes dhe numrin e telefonit të kujdesit për klientin.


## 12 Manuali i montimit

Mbani parasysh këto informacione gjatë montimit të pajisjes.




### 12.1 Përmbajtja e paketimit

Pas nxjerrjes nga paketimi kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti dhe për plotësinë e dërgesës.



### 12.2 Përmasat e pajisjes


Këtu gjeni përmasat e pajisjes





### 12.3 Distancat e sigurisë

Respektoni distancat e sigurisë së pajisjes.




### 12.4 Montimi i sigurt

Ndiqui këto udhëzime për sigurinë kur të montoni pajisjen.

#### **PARALAJMËRIM – Rrezik helmimi!**

Rithithja e gazeve të djegies mund të shkaktojë helmime. Pajisjet që prodhojnë nxehtësi dhe punojnë në varësi të ajrit të ambientit (p.sh. sobat, kaldajat me qarkullim uji, bojlerët për ujë të ngrohtë që punojnë me gaz, naftë, dru ose qymyr) e tërheqin ajrin e djegies nga dhoma e instalimit dhe e nxjerrin tymin jashtë përmes një sistemi shkarkimi (p.sh. oxhak). Në kombinim me aspiratorin e ndezur, ajri i kuzhinës dhe dhomave përreth thithet dhe nxirret jashtë. Kur nuk ka një furnizim të mjaftueshëm me ajër, atëherë krijohet presion negativ/vakuum. Gazet helmuese nga oxhaku ose kafazet e ajrimit do të thithen sërish në ambientet e ndenjes.



- ▶ Kujdesuni gjithmonë që të ketë një furnizim të mjaftueshëm me ajër kur pajisja përdoret në modalitetin me nxjerrje ajri në të njëjtën kohë me një pajisje që prodhon nxehtësi, që punon në varësi të ajrit të ambientit.
- ▶ Një përdorim pa rreziqe është i mundur vetëm kur presioni negativ në dhomën e montimit të pajisjes që prodhon nxehtësi nuk tejkalon 4 Pa (0,04 mbar). Kjo mund të arrihet kur ajri i nevojshëm për djegien mund të sigurohet përmes vrimave që nuk bllokohen, p.sh. tek dyert, dritaret, në

- kombinim me një zgavër në mur për hyrjen / daljen e ajrit ose nëpërmjet masave të tjera teknike. Vetëm një zgavër në mur për hyrjen/daljen e ajrit nuk arrin të sigurojë ruajtjen e vlerave brenda kufijve.
- ▶ Në çdo rast, këshillohuni me një specialist të sistemit të ngrohjes, i cili mund të vlerësojë të gjithë ajrimin e shtëpisë dhe t'ju këshillojë masat e përshtatshme për ajrimin.
  - ▶ Përdorimi i pajisjes është i mundur pa kufizime atëherë kur ajo përdoret vetëm në modalitetin me qarkullim ajri.

Rithithja e gazeve të djegies mund të shkaktojë helmime.

- ▶ Nëse instalohet një aspirator me një pajisje ngrohëse që varet nga ajri i ambientit, duhet që linja e ushqimit me energji e aspiratorit të parashikohet me një çelës sigurie.

Rithithja e gazeve të djegies mund të shkaktojë helmime.

- ▶ Mos e nxirni ajrin për shkarkim në një oxhak tymi ose në një oxhak gazesh i cili është funksional.
- ▶ Mos e nxirni ajrin për shkarkim në një kafaz, i cili shërben për ajrimin e ambienteve të instalimit të pajisjeve që prodhojnë nxehtësi.
- ▶ Nëse shkarkimi i ajrit do të bëhet në një oxhak tymi ose gazi që nuk është në përdorim, duhet marrë paraprakisht aprovimi i kompanisë përkatëse përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemit të oxhakëve.

#### **PARALAJMËRIM – Rrezik asfiksioni!**

Fëmijët mund të fusin në kokë ose të mbështillen me materialin e paketimit dhe për rrjedhojë të mbyten.

- ▶ Mbani larg fëmijëve materialin e paketimit.
- ▶ Mos i lini fëmijët të luajnë me materialin e paketimit.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik zjarri!**

Depozitimet e yndyrës në filtrin e yndyrës mund të marrin flakë.

- ▶ Distanca e dhëna të sigurisë duhet të respektohen për të shmangur një akumulim të nxehtësisë.
- ▶ Respektoni specifikimet për pajisjet tuaja të gatimit. Nëse tek udhëzimet e instalimit të pajisjeve të gatimit është dhënë një distancë e ndryshme, atëherë merrni gjithmonë në konsideratë distancën më të madhe. Nëse përdorni së bashku vatra gatimi me gaz dhe vatra me korrent, atëherë është e vlefshme distanca më e madhe e dhënë.

Depozitimet e yndyrës në filtrin e yndyrës mund të marrin flakë.

- ▶ Mos punoni asnjëherë me një flakë të hapur në afërsi të pajisjes (p.sh. me ushqime me flakë).
- ▶ Pajisjen mund ta instaloni në afërsi të një oxhaku për lëndë djegëse të forta (p.sh. dru, qymyr), vetëm kur ai ka një mbulesë të mbyllur dhe që nuk hiqet. Jashtë tij nuk duhet të dalin shkëndija.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!**

Pjesët brenda pajisjes mund të jenë me qoshe të mprehta.

- ▶ Vishni doreza mbrojtëse.
- Nëse pajisja nuk është fiksuar siç duhet, ajo mund të bjerë.
- ▶ Të gjitha elementet e mbërthimit duhet të montohen fort dhe në mënyrë të sigurt.
- Ndryshimet në sistemin elektrik apo mekanik janë të rrezikshme dhe mund të çojnë në keqfunksionim.

- ▶ Mos bëni asnjë ndryshim në sistemin elektrik ose mekanik.

Kapaku i filtrit mund të lëkundet.

- ▶ Hapeni me ngadalë kapakun e filtrit.
- ▶ Pas hapjes mbani të kapur kapakun e filtrit derisa ai të mos lëkundet më.
- ▶ Mbyllni me ngadalë kapakun e filtrit.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!**

Pjesët me cepa të mprehtë në brendësi të pajisjes mund të dëmtojnë kordonin elektrik.

- ▶ Mos e përthyeri ose mos e pickoni kordonin elektrik.

Instalimet e parregullta janë të rrezikshme.

- ▶ Lidheni pajisjen dhe vëreni në përdorim vetëm në rrjet elektrik sipas të dhënave në etiketën e parametrave.
- ▶ Lidheni pajisjen vetëm nëpërmjet një prize të instaluar sipas rregullave me tokëzim, në një rrjet elektrik me rrymë alternative.
- ▶ Sistemi mbrojtës i instalimit elektrik të shtëpisë duhet të jetë instaluar sipas rregullave.
- ▶ Asnjëherë mos e ushqeni pajisjen përmes një aparature të jashtme vepruese, si p.sh. kohëmatës ose telekomandim.
- ▶ Kur pajisja është e montuar inkaso, spina e kordonit elektrik duhet të jetë lehtësisht e arritshme. Kur aksesimi i lirë nuk është i mundur, në instalimin e përcaktuar elektrik duhet instaluar një çelës ndarës shumëpolësh, sipas kërkesave të kategorisë së mbitemensionit III dhe sipas dispozitave të ndërtimit.
- ▶ Gjatë instalimit të pajisjes bëni kujdes që kordonit elektrik të mos ngecet ose që të mos dëmtohet.

## **12.5 Udhëzime të përgjithshme**

Ndiqui këto udhëzime të përgjithshme gjatë instalimit.

- Për instalimin duhen ndjekur rregulloret aktuale në fuqi për ndërtimin dhe rregullat e furnizuesve lokalë të energjisë elektrike dhe të gazit.
- Për shtrimin e tubacionit për nxjerrjen e ajrit duhen zbatuar rregulloret zyrtare dhe ligjore, si p.sh. kodi i ndërtimit.
- Zgjidhni një vend montimi lehtësisht të aksesueshëm për ta arritur pajisjen sa më lehtë në rast të një shërbimi të mundshëm.
- Sipërfaqet e pajisjes janë delikate. Shmangni dëmtimet e mundshme gjatë montimit.

## **12.6 Udhëzime për lidhjen elektrike**

Ndiqui këto udhëzime për ta lidhur pajisjen në mënyrë të sigurt nga ana elektrike.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!**

Shkëputja e pajisjes nga rrjeti elektrik duhet të jetë e mundur në çdo moment. Pajisja duhet të lidhet vetëm në një prizë me kontakte mbrojtëse e instaluar sipas rregullave.

- ▶ Spina e kordonit elektrik duhet të jetë lehtësisht e arritshme pas instalimit të pajisjes.
- ▶ Kur kjo nuk është e mundur, në instalimin e përcaktuar elektrik duhet instaluar një çelës ndarës shumëpolësh, sipas kërkesave të kategorisë së mbitemensionit III dhe sipas dispozitave të ndërtimit.
- ▶ Realizimi i shtrirjes së instalimeve elektrike fikse lejohet të bëhet vetëm nga një specialist elektrikist. Ne rekomandojmë të instaloni një automat mbrojtës ndaj rrjedhjes së rrymës (çelës automat FI) në qarkun elektrik të furnizimit të pajisjes.

Pjesët me cepa të mprehtë në brendësi të pajisjes mund të dëmtojnë kordonin elektrik.

- ▶ Mos e përthyeri ose mos e pickoni kordonin elektrik.
- Specifikimet e lidhjes i gjeni në etiketën e parame-trave. → *Stran 24*
- Gjatësia e kordonit elektrik është rreth 1,30 m.
- Kjo pajisje është në përputhje me dispozitat e Bashkimit Evropian për eliminimin e interferencave radio.
- Pajisja i përket klasës së mbrojtjes 1. Për këtë arsye duhet të vihet në përdorim vetëm me një prizë të tokëzuar.
- Mos e lidhni pajisjen në rrjetin elektrik gjatë montimit.
- Sigurohuni që mbrojtja ndaj kontaktit elektrik të sigurohet nga instalimi.

## 12.7 Udhëzime për vendin e instalimit

- Montojeni këtë pajisje në një dollap të kuzhinës.
- Për montimin e aksesorëve shtesë të veçantë ndiqni manualin e instalimit që jepet me ata aksesorë.
- Gjerësia e aspiratorit duhet të përputhet të paktën me gjerësinë e vatrës së gatimit.
- Në mënyrë që avujt e gatimit të thithen sa më mirë, montojeni pajisjen në qendër mbi planin e gatimit.

## 12.8 Udhëzime për tubacionin e nxjerrjes së ajrit

Prodhuesi i pajisjes nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për ankesat që lidhen me linjën e tubave.

- Përdorni një tub të shkurtër dhe të drejtë për nxjerrjen e ajrit, me një diametër tubi mundësisht të madh.
- Tubat e gjatë e të fortë të nxjerrjes së ajrit, bërrylat e shumtë ose diametri i vogël i tubave zvogëlojnë rendimentin e thithjes së ajrit dhe rritin zhurmën e ventilatorit.
- Përdorni një tub ajri prej materiali që nuk digjet.
- Montojeni tubin e nxjerrjes së ajrit me pjerrësi 1° nga pajisja, për të parandaluar kthimin mbrapsht të ujit të kondensimit.

### Tubat rrethorë

Përdorni tuba rrethorë me diametër të brendshëm 150 mm (e rekomanduar) ose minimumi 120 mm.

### Kanalet e sheshta

Përdorni kanale të sheshta, seksioni tërthor i brendshëm i të cilave përputhet me diametrin e brendshëm të tubave rrethorë:

- Diametri 150 mm përkon me rreth 177 cm<sup>2</sup>.
- Diametri 120 mm përkon me rreth 113 cm<sup>2</sup>.
- Nëse diametrat e tubave ndryshojnë, vendosni garancion hermetizues.
- Mos përdorni kanale të sheshta që kanë kthesa të forta.

## 12.9 Udhëzime për modalitetin me nxjerrje ajri

Në modalitetin me nxjerrje jashtë të ajrit duhet montuar një valvul moskthimi.

### Shënime

- Kur pajisja nuk shoqërohet me një valvul moskthimi, valvula e moskthimit mund të blihet te një dyqan i specializuar.
- Kur nxjerrja e ajrit do të bëhet përmes murit të jashtëm, duhet të përdoret një tub teleskop me grilë.

## 12.10 Udhëzime për modalitetin me qarkullim ajri

Pajisja duhet të përdoret vetëm nëse është e instaluar në mënyrë fikse dhe me tubat e montuar.

## 12.11 Montimi

### Verifikimi i mobilies


1. Kontrolloni nëse mobilia e montimit është e drejtë dhe ka kapacitet mbajtës të mjaftueshëm. Peshë maksimale e pajisjes është rreth 10 kg.  
**Shënim** Mbani parasysh specifikimet e prodhuesit të mobilies lidhur me kapacitetin mbajtës të mobilies së instalimit.
2. Sigurohuni që mobilia e montimit është rezistente ndaj nxehtësisë deri në 90°C.
3. Sigurohuni që mobilia e montimit është e qëndrueshme edhe pas punimeve të prerjes.

### Përgatitja e mobilies



**Kërkesë:** Mobilia është e përshtatshme për montimin inkaso.

→ "*Verifikimi i mobilies*", Faqe 27

1. Realizoni në mobiline prerjen për pajisjen.




2. Realizoni prerjen për tubin e nxjerrjes së ajrit ose lart në mobilen e montimit, ose prapa mobilies së montimit inkaso.




### Përgatitja e pajisjes


1. Montoni valvulën e moskthimit në vrimën e daljes së ajrit dhe mbërthejeni.




2. Hapni kapakun e filtrit.  
– Kapni kapakun e filtrit në cepat përpara dhe shtyjeni menjëherë për poshtë.




3. Lironi siguresën e menteshës dhe hiqni kapakun e filtrit.



4. Hiqni filtrin e yndyrës.  
Mos e përthyeri filtrin e yndyrës, për të shmangur kështu ndonjë dëmtim të mundshëm.  
5. Lironi kabllon e panelit të komandimit dhe kabllon e ndriçimit.




6. Lironi vidat e mbërthimit të kornizës ① dhe hiqni kornizën ②.



**Përgatitja e modalitetit me qarkullim ajri**


1. Poziciononi saktë mbajtësen e filtrit mbi motor ① dhe rrotullojeni për përpara derisa sa të mbërtheni ②.




2. Shtyni filtrin e aromave në mbajtësen e filtrit.

**Montimi i pajisjes**


1. Futni pajisjen në hapësirën e mobiljes ① dhe mbërthejeni me vida në mobilien e montimit ②.




2. Shtërngoni vidat e mbërthimit.



3. Vendosni në vend kornizën dhe mbërthejeni nga poshtë me vida me pajisjen.




4. Siguroni kornizën dhe pajisjen me vida.




Kur vidat nuk janë të arritshme nga jashtë, vidat mund të montohen edhe nga brenda.

5. Lidhni sërisht kabllon e panelit të komandimit dhe kabllon e ndriçimit.



Spina mund të futet vetëm në një pozicion.


6. Sigurohuni që filtri i yndyrës të jetë vendosur mirë.



7. Vendosni në vend filtrin e yndyrës. Mos e përthyeri filtrin e yndyrës, për të shmangur kështu ndonjë dëmtim të mundshëm.
8. Vendosni në vend kapakun e filtrit dhe mbylleni.

## Realizimi i lidhjes për nxjerrjen e ajrit

1. Fiksoni tubin e nxjerrjes së ajrit te vrima e ajrit.




2. Realizoni lidhjen në vrimën për nxjerrjen e ajrit.
3. Izoloni hermetikisht vendin e lidhjes.

## Realizimi i lidhjes së qarkullimit të ajrit

Seti standard i qarkullimit të ajrit ofrohet për shitje si aksesori.

1. Fiksoni tubin e nxjerrjes së ajrit te vrima e ajrit.
2. Realizoni lidhjen për vrimën në mobilien e montimit.



3. Mbërtheni me vida rretën drejtuese të ajrit në mobilien e montimit.
4. Izoloni hermetikisht vendin e lidhjes.

## Kryerja e lidhjes elektrike

1. Futni spinën e rretit në prizën elektrike me kontakt mbrojtës.
2. Nëse kërkohet një lidhje fikse, shihni udhëzimet në kapitullin  
→ "Udhëzime për lidhjen elektrike", Faqe 26.

## Çmontimi i pajisjes

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!**

Pjesët brenda pajisjes mund të jenë me qoshe të mprehta.

► Vishni doreza mbrojtëse.

1. Shkëputni pajisjen nga rrjeti elektrik.
2. Lironi tubin e nxjerrjes së ajrit.
3. Nëse nevojitet, hapni kapakun e filtrit.
4. Hiqni filtrin e yndyrës.  
Mos e përthyeri filtrin e yndyrës, për të shmangur kështu ndonjë dëmtim të mundshëm.
5. Hiqni kornizën.
6. Lironi kabllon e panelit të komandimit dhe kabllon e ndriçimit.
7. Lironi lidhjen me vida në mobilien e montimit.
8. Ulni poshtë pajisjen me ngadalë.

# Sadržaj

## UPUTSTVO ZA UPOTREBU

1	Bezbednost.....	31
2	Izbegavanje materijalne štete.....	33
3	Zaštita životne sredine i štednja .....	33
4	Podešavanje prikaza zasićenosti.....	34
5	Upoznavanje sa uređajem .....	34
6	Pribor .....	35
7	Osnovno rukovanje.....	35
8	Čišćenje i održavanje.....	35
9	Otklanjanje smetnji .....	38
10	Odlaganje u otpad.....	38
11	Korisnička služba.....	39
12	UPUTSTVO ZA MONTAŽU .....	39
12.4	Bezbedna montaža.....	40

## 1 Bezbednost

Pridržavajte se sledećih sigurnosnih napomena.

### 1.1 Opšte napomene

- Pažljivo pročitajte ovo uputstvo.
- Uputstva i informacije o proizvodu sačuvajte za kasniju upotrebu ili za narednog vlasnika.
- Ukoliko postoji oštećenje nastalo tokom transporta, nemojte da priključujete uređaj.

### 1.2 Namenska upotreba

Ovaj uređaj je namenjen samo za ugradnju. Obratite pažnju na posebno uputstvo za montažu.

Samo u slučaju stručne ugradnje u skladu sa uputstvom za montažu zagarantovana je sigurnost prilikom upotrebe. Instalater je odgovoran za pravilno funkcionisanje na mestu postavljanja.

Ovaj uređaj upotrebljavajte samo:

- za usisavanje pare od kuvanja.
- u privatnom domaćinstvu i u zatvorenim prostorima kućnog okruženja.
- na nadmorskim visinama do 2000 m.

Ne upotrebljavajte uređaj:

- sa eksternim tajmerom.

### 1.3 Ograničenje kruga korisnika

Deca od 8 godina i starija, kao i osobe sa umanjnim psihičkim, čulnim ili mentalnim sposobnostima, ili osobe bez iskustva i/ili znanja, ovaj uređaj mogu da koriste samo pod nadzorom osobe koja je odgovorna za njihovu bezbednost ili ako su obučene za bezbedno korišćenje uređaja i razumeju kakve opasnosti pri tome postoje.

Deca se ne smeju igrati uređajem.

Čišćenje i korisničko održavanje ne smeju da obavljaju deca, osim ako su starija od 15 godina i to rade pod nadzorom.

Decu mlađu od 8 godina udaljite od uređaja i od priključnog kabla.

### 1.4 Bezbedna upotreba

#### UPOZORENJE – Opasnost od gušenja!

Deca mogu ambalažni materijal da navuku sebi preko glave ili da se njime umotaju, pa da se tako uguše.


- ▶ Ambalažni materijal držite van domašaja dece.
- ▶ Deci nipošto nemojte dozvoliti da se igraju sa ambalažnim materijalom.

Deca bi mogla da udahnu i usisaju odn. progutaju sitne delove i da se na taj način uguše.

- ▶ Držite sitne delove van domašaja dece.
- ▶ Deci nipošto nemojte dozvoliti da se igraju sa sitnim delovima.

**⚠ UPOZORENJE – Opasnost od trovanja!**

Zapaljivi gasovi koji su usisani nazad mogu da dovedu do trovanja. Vatrišta koja zavise od vazduha u prostoriji (npr. grejni uređaji na gas, ulje, drvo ili ugalj, protočni bojleri, kotlovi za zagrevanje vode) vazduh za sagorevanje crpe iz prostorije u koju su postavljeni i izduvne gasove izbacuju preko sistema za izduvne gasove (npr. dimnjak) u spoljašnju sredinu. U kombinaciji sa uključenim aspiratorom uzima se vazduh iz kuhinje i susednih prostorija. Bez dovoljnog dotoka vazduha nastaje potpritisak. Otrovni gasovi iz dimnjaka ili odvodnog okna usisavaju se nazad u stambene prostorije.



- ▶ Uvek se pobrinite za dovoljno dotoka vazduha, ako uređaj upotrebljavate u režimu odvoda vazduha istovremeno sa vatrištem koje zavisi od vazduha u prostoriji.
